



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

**PËR PROJEKT RREGULLOREN PËR THEMELIMIN E
MARRËDHËNIES SË PUNËS ME KONTRATË PËR NJË PERIUDHË
TË CAKTUAR NË ADMINISTRATËN E SISTEMIT GJYQËSOR**

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës në administratën e sistemit gjyqësor me kontratë për një periudhë të caktuar.

Përmes kësaj projekt rregullore synohet që dispozitat e saj të jenë të zbatueshme për të gjithë nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor.

Me këtë projekt rregullore përcaktohet themelimi i marrëdhënies së punës për periudhë të caktuar, themelimi i marrëdhënies së punës për realizimin e projektit të caktuar, si dhe për plotësimin e një pozitë në rast të mungesës së përkohshme.

Projekt rregullorja përcakton themelimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve i cili themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, duke pasqyruar një përbërje gjinore dhe etnike.

	<p>Procedura e pranimit sipas projekt rregullore zhvillohet në dy (2) faza:</p> <ol style="list-style-type: none">1. fazën e verifikimit paraprak e cila behet nga ana e NjMBNj; dhe ,2. fazën e vlerësimit profesional i cili behet nga komisionit përzgjedhës në mbështetjen të NjMBNj, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve përmes intervistës me gojë. <p>Rregullorja përcakton një minimum dhe një maksimum për sa i përket pikëve të vlerësimit të intervistës me gojë. Në dispozitat e saj, ajo cakton që kandidatët duhet të marrin të paktën një numër prej 70 pikëve. Po ashtu, përcakton edhe pikët maksimale prej 100 pikësh që mund të marrë një kandidat, nga intervista prej të cilave 30 pikë janë për jetëshkrimin (CV).</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Hartimit i Projekt Rregullore për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në administratën e sistemit gjyqësor është paraparë e nevojshëm për shkak të ndryshimeve ligjore, perkatësisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik, sipas së cilit kërkohet një rregullim i veçantë.</p> <p>Andaj, përmes hartimit të kësaj projekt rregullore synohet të rregullohen në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse kriteret dhe rregullat për përcaktimin e themelimit të marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në</p>

	<p>administratën e sistemit gjyqësor. Pasi që deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji, kjo procedure është rregulluar ne përputhje me rregullativen ligjore të shërbimit civil.</p> <p>Hartim i kësaj rregullore është e rëndësishme sepse përbën akt unifikues për sistemin e administratës gjyqësore, për rregullimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar, duke filluar nga aplikimi e deri tek shpallja e rezultatit përfundimtar, sipas një rregullore të vetme, procedurë kjo e cila nuk ka qenë e rregulluar më parë me një akt veçantë.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të projekt Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për një periudhë të caktuar në Administratën e Sistemit Gjyqësor.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 20 prill 2024.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft të rregullores përmes postës</p>

elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net